

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to; ID 7.7, germa a “Thertore”, sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”

Person fizik: HYSNI TAFA

NIPT: K63027805P

Vendndodhja: Lagjia Xekave, objekt 1-katesh, Zona Kadastrale nr.2539, Pasuria nr, 234/3, Luz i vogel, Kavaje, Qarku Tirane.

Tirane 2021

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Subjekti "HYSNI TAFÄ" është regjistruar ne QKR me date **26/06/2006**, me objekt aktiviteti **Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to ID 7.7, germa a "Thertore"**. Ai është regjistruar me Forme Ligjore si **Person Fizik**, me NIPT: **K63027805P**.

Per kete aktivitet ky subjekt është pajisur me Leje Mjedisi Tipi C me **Nr.identifikimi 451, Nr. Prot 451** dhe **date 21.12.2017** per **Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to ID 7.7, germa a "Thertore"**. *Bazuar Ligjit 52/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar"*, ky subjekt kerkon te pajiset me Leje tipi B per aktivitetin ne fjale.

Aktiviteti zhvillohet në fshatin Luz i Vogël, rruga Kavajë – Spille, Bashkia Kavajë. Kjo pronë ka në sipërfaqe prej 3254 m². Objekti ndodhet në një sipërfaqe të sheshtë. Kati përdhe fillon në kuotën ± 0.00 m dhe mbaron në kuotën maksimale të tij + 6.50 m. Në funksion të objektit janë ndërtuar dy gropa septike për dekantimin e shkarkimeve që mund të vijnë nga ushtrimi i aktivitetit me dimensione 4 x 4 m e thellësi rreth 2 m dhe një gropë septike me dimensione 2 x 2 m me thellësi 2m për ujrat e ndotura. Gropat septike janë të mbyllura me kapak gize, të cilat menaxhohen nga subjekti pas fazës së ndërtimit dhe nuk përbëjnë shqetësim për komunitetin e zonës. Fasada është e përbërë me konstruksion betonarme dhe nga elementë metalik tek dyert kryesore me vetrata të lëvizshme të cilat mundësojnë hapjen totale. Ndërtesa është me mbulesë soletë monolite betonarme dhe me lartësi dysHEME tavan 5.70 m në kulmin e saj.

2. VENDODHJA E AKTIVITETIT

Vendodhja e aktivitetit eshte ne fshatin Luz i Vogel, rruga autostrade – Spille, ne periferine jugore te Bashkise se Kavajes. Eshte jashte zones se urbanizuar ne distance prej rreth 200 m ne jug dhe 370 m ne lindje te objekteve te banimit. Sheshi eshte ne gjendje funksionale dhe i shfrytezueshem.



	<i>Koordinatat: Albanian 1986/ Gauss- Kruger Zone 4</i>	
	<i>East (Lindje)</i>	<i>Nord (Veri)</i>
<i>Pika A</i>	4381226.38	4555786.14
<i>Pika B</i>	4381233.83	4555764.21
<i>Pika C</i>	4381117.66	4555606.09
<i>Pika D</i>	4381109.10	4555718.03

3. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

-Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim ne peizazhin e zones;

-Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

• Periudha e funksionimit

Procesi i punes fillon me pranimin e gjetheve dhe dhenve përpara procesit të therjes. Si zgjidhje teknike eshte ndertuar nje ambjent ne hyrje te nderteses me permasa 12 x 4.5 m. Gjate procesit te therjes, kushtet e punes jane ne perputhje me parametrat e nevojshem teknike, teknologjine dhe rekomandimet e siguruara, ne bashkepunim te vazhdueshem me furnitoret, specialiste veterinare nga institucionet perkatese kombetare, nderkombetare, etj. Me konkretisht, ketu perfshihen: temperatura e mjedisit, sistemi i ventilimit, permbajtja e lageshtise, sasia e ndricimit, ngarkesa mikrobike e mjedisit, dhomat frigoriferike, sherbimet veterinare dhe kushtet shendetesore, si mjet parandalimi per te ruajtur mishin, nga infektimet apo semundje te ndryshme, qe mund te transmentohen si rezultat I neglizhences se masave te nevojshme. Objekti ka 2 gropa septike per dekantimin e gjakut me dimensione 4 x 4m me thellesi 2 m, ka dhe 1 grope septike per ujerat e zeza me dimensione 2 x 2m me thellesi 2m, strukture beton/arme e mbyllur me kapak gize.

• Sistemim i ambjentit te jashtem

Objekti eshte strukture beton/tulle. Objekti ka nje lartesi maksimale prej 5.7 m. Fasadat jane te perbera nga elemente moderne te kombinuar me ngjyrat te cilat e vecojne kete strukture nga strukturat e tjera rrethuese. Keto elemente te nderthurura e bejne kete objekt qe te kete nje impakt visiv terheqes. Per mbajtjen ne kushte normale te mikroklimes jane vendosur ventilator ajrosje qe sigurojne ne parametra normale te niveleve te ajrit. Mjedisi i jashtem ku do dalin pulat per levizje eshte i rrethuar me rrjeta teli anesore dhe siperore per moslejuar daljen e kafsheve apo hyrjen e personave te paautorizuar. Ndertesa eshte e pajisur me

sistemin kunder zjarrit si dhe me gjeneratorin perkates te energjise. Nepermjet instruksioneve dhe kualifikimeve perkatese, realizohet kontrolli intensiv periodik i kushteve higjieno-sanitare dhe stabilizimi i ventilimit, ndricimit, lageshtise dhe temperatures se ajrit, furnizimit me uje te pijshem, sipas paramentrave teknike, etj. Karantina e rrepte veterinare aplikohet qe ne hyrje te ndermarrjes, qe nga njerezit deri tek automjetet, qe i neshtrohen dezinfektimit dhe kontrollit rigoroz. Nje rendesi e vecante i kushtohet gjendjes shendetesore te personelit, i cili i nenshtrohet periodikisht analizave te kontrollit mjekesor, per t'u siguruar qe nuk ka mbartes semundjesh, qe mund t'i transmetojne ato tek shpendet.

Perdoren veshje te posatshme per hyrje te personelit te autorizuar ne kapanone, bateri, qendra grumbullimi, mjedise magazinimi, fabrike ushqimi, mjete transporti etj.

Gjithashtu shoqeria do te kete ne funksion dhoma te vecanta per ndarjen e plencave dhe lekurave gjate procesit te therjes. Sherbimi teknik veterinar, do te ushtroje nje kontroll te vazhdueshem gjate te gjithë periudhes se shfrytezimit te vepres.

Procesi I kontrollit veterinar do te shtrihet pergjate fazave te meposhtme:

- Lendet e para; duke filluar nga casti kur ato hyjne ne thertore (viça, qengja, keca, etj.)
- Produkte ne proces; ne momente te ndryshme te procesit teknologjik (therja, pastrimi, etj.)
- Ambienti: si brenda ashtu dhe jashte ndertesës (temperatura, lageshtia, ngarkesa kimiko-bakteriale, ajrosja, etj.)

Foto te aktivitetit



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NIPT K63027805P



5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I NDIKIMEVE NE MJEDIS

- Metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve negative ne mjedis

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhteme:

- Njohja me projektin dhe sherbimet qe ai ofron.
- Nohja me paisjet dhe aparaturat qe sherbejne per kryerjen e ketyre sherbimeve.
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe vendit ku ndodhet thertorja.
- Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojen per infrastrukture te re per projektin.
- Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zbatimin e projektit.

Shkarkime ne uje

Ambjenti I thertores dhe stabilimentit te perpunimit te mishit do te jete I pajisur me system kanalizimiesh, ujrata qe do te dalin nga aktiviteti i thertores si dhe ujrata gjate pastrimit te ambjenteve te punes, kalojne ne vaska dekantuese, ku ka dhe rrjeta te imta per filtrimin e ujit, me pas keto ujera do te kalojne ne impiantin e trajtimit te ujrave te perdorura qe do te ndertohet nga vete subjekti.

Shkarkime ne ajer

Emetime ne ajer nga funksioni i ketij objekti nuk do te kete. Ne kete objekt nuk do te kete impiante me djegie dhe nuk do te kete shkarkime te gazeve te demshem per mjedisin. Perdorimi i gjeneratorit, ne raste te nderprerjes se energjise elektrike duhet te jete silencioz, me lende djegese nafte te paster, te perpunuar m parametrat e shitjes ne treg. Oret e punes teper te reduktuara.

Zhurma dhe vibrime

Zhurmat qe do te krijohen gjate funksionimit te ketij objekti do te jene gjate proceseve te punes. Keto zhurma do te jene ne nivele minimale dhe te kontrollueshme.

Mbetje

Mbetjet e gjeneruara nga procesi teknologjik, do te trajtohen nga kompania e licensuar "AZ RENDERING" Shpk, me te cilen subjekti ku zhvillohet aktiviteti ka lidhur kontrate. Objekt I kesaj kontrate do te jete "Evadimi I mbetjeve te grumbulluara, te krijuara nga veprimtaria prodhuese e shoqerise porositese, qe ne vetvete perbehet nga sherbime qe perfshijne grumbullimin, transportimin dhe perpunimin e tyre".

Mbetjet e ngurta qe do te prodhohen nga aktiviteti human do te jene mbetjet e ngurta si plastika, shishe qelqi, materiale letre etj. Keto mbetje do te menaxhohen ne bashkepunim me NJ.Q.V.

6. MASAT PER MINIMIZIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS

Asgjesimi ose riciklimi i karkasave te kafsheve

-Procesi i renderimit te mishit te kuq trajton nenproduktet e mishit te kuq. Nenproduktet e mishit te kuq qe nuk jane te destinuara per konsum njerezor shendrohen ne proteina, minerale dhe yndyrna te vlefshme.

Skema e procesit te renderimit: ngarkimi i lendes se pare ne proces, transportues (konvejer) i lendes se pare, grites i lendes se pare, dozator, kontenitori me presion i renderimit, konvejer i materies se perpunuar largues i lageshtires, prese, sedimentues, centrifuge per vecimin e ynyrnave, paisje per filtrimin e avujve, kondesues i avullit.

-Ambjentet e ketij subjekti do te pajisen me puseta dhe kanalizime qe sherbejne per kalimin e ujerave te ndotur te procesit teknologjik dhe ato sanitare ne impiantin e trajtimit te ujerave per te mos shkaktuar derdhjen e tyre ne mjedis.

-Territori i objektit do te mbahet i paster, i dizifektuar dhe i rregullt. Nuk do te lejohet grumbullimi i gjakut, llumrave apo shkarkimi i ujerave te ndotur qe dalin nga larja dhe pastrimi pas procesit te therjes se kafsheve; per kete arsye pas cdo therjeje vendi pastrohet.

-Per sa i perket mbrojtjes se ajrit, subjekti ka planifikuar per te instaluar sistem nje ventilimi ne ambjentet e punes per te bere te mundur qarkullimin dhe pastrimin e ajrit te brendshem nga aromat e keqija qe clirohen gjate procesit te therjes se kafsheve.

Person Fizik
HYSNI TAFA